

RELACIONI TEKNIK

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION LINJA KANALIZIMI TË UN DHE UB, LAGJJA NR. 1 SHESHI “TAULANTIA”,LAGJJA NR.13 RRUGA ”P. MGJERGO” LAGJJA NR.14 RRUGA”B. TUSHA”DHE LAGJJA NR.17 RRUGA“GLAUKIA”, DHE “VLLAZËRIMI”, DURRE’S”

RAPORTI TEKNIK

OBJEKTI : “RIKONSTRUKSION LINJA KANALIZIMI TË UN DHE UB, LAGJJA NR. 1 SHESHI “TAULANTIA”,LAGJJA NR.13 RRUGA ”P. MGJERGO” LAGJJA NR.14 RRUGA”B. TUSHA” DHE LAGJJA NR.17 RRUGA “GLAUKIA”, DHE “VLLAZËRIMI”, DURRËS”

I. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT .

1. Të Përgjithshme

Hartimi i projektit të objektit:”Rikonstrukcion linja kanalizimi të UN dhe të UB “Lagjja nr.1 sheshi“Taulantia”, Lagjja nr.13 rruga”Prokop Mgjergo”,lagjja nr.14 rruga”Bajram Tusha” lagjja nr.17 rruga“Glaukia”, dhe“Vllazërimi”, Bashkia Durrës”, është bërë nga stafi i Degës Teknike sh.a Durrës bazuar në shqetësimet e qytetarëve për dëmtime të tubacioneve të ujërave të ndotura, si dhe të tubacioneve të ujërave të bardha, të cilat shkaktojnë përmytje të rrugëve në ditët me rreshje të shumta atmosferike duke sjellë shqetësime jo vetëm për banorët, por edhe për qarkullimin e mjeteve.

Shkarkimi i ujërave të ndotura për secilin segment rrugor do të bëhet në kolektorët ekzistues, ndërsa shkarkimi i ujërave të bardha do të bëhet në det.

2. Vendndodhja e objektit dhe gjendja ekzistuese e rrjetit të kanalizimeve

Zonat ku do të kryhet investimi ndodhen në pjesë të ndryshme të qytetit.dhe kryesisht:

- Lagjja nr.1 sheshi”Taulantia”

Kjo zonë ndodhet në pjesën jugore të qytetit, në aneksin e sheshit”Taulantia”, pranë ish hotel “Ani”.Tubacioni i kanalizimit të ujërave të bardha HDPE Ø315 mm në këtë segment, jo vetëm që nuk përballon prurjet e mëdha në periudha rreshjesh, por ai ka pësuar dëmtime për shkak të punimeve në rrugë nga subjekte private, si dhe nga kalimi i shpeshtë i mjeteve të qytetarëve, pasi ky segment lidhet me shëtitoren pranë detit ku kryejnë aktivitetin e tyre shumë Bar-Restarante-Piceri.

Referuar këtij fakti, zëvendësimi i këtij tubacioni me tubacion HDPE SN8 Ø 600 mm me gjatësi L=110 m, do të mundësojë eliminimin e fenomenit të përmbutjeve dhe të ndotjes së ambjentit. Në këtë linjë do të ndërtohen 2 puseta shkarkimi 80x80 cm h=150 cm si dhe zgara shimbledhëse në fillim të linjës, e cila do të mbledhë ujërat e bardha të rrugës "Taulantia".

- Lagjja nr.17 rrugët "Glaukia", "Vllazërimi"

Kjo zonë ndodhet në pjesën veri-lindore të qytetit, pranë Tregut të madh Industrial si dhe në segmentin rrugor që lidhet me autostradën Durrës-Tiranë.

Në rrugën "Glaukia", kolektori kryesor i ujërave të ndotura S-11, Ø 600 mm b/arme, kalon përmes disa shtëpiave private. Ky kolektor duke qenë i amortizuar dhe i bllokuar për shkak të pamundësisë së pastrimit ndër vite, është bërë pengesë për lëvizjen e ujërave të ndotura, gjë e cila ka shaktuar daljen e tyre në oborret e shtëpiave si dhe në sipërfaqe të rrugës kryesore "Glaukia".

Devijimi i këtij segmenti të kolektorit kryesor i cili do të realizohet me tubacion Ø 500 mm HDPE, do të sigurojë përcjellshmëri të lartë të këtij kolektori dhe do të eliminojë fenomenin e përmbutjeve.

Në këtë tubacion do të ndërtohen 5 puseta kontrolli 1x1x1.5 m, të cilat do të bëjnë të mundur pastrimin e heër pas herëshëm të kolektorit kryesor.

Në rrugën "Vllazërimi", kolektorët sekondarë që mbledhin ujërat e ndotura të skolinave në pjesën djathtas aksit të kësaj rruge, kryesisht kolektorët e rrugëve sekondare "Nikolin Xhoja", "Principata e Arbërit" dhe "Adem Jashari", shkarkojnë në tubacionin ekzistues Ø 400 mm betoni, shkarkimi i të cilit nuk është i realizuar sipas kushteve teknike nga subjekti ndërtues. Për arsye të mosfunksionimit ndër vite, bllokimi i këtij tubacioni ka shaktuar përmbutje të herë pas herëshme të rrugëve sekondare dhe të ambjenteve përreth shtëpiave private.

Shkarkimi i tubacioneve ekzistuese Ø 400 mm betoni të rrugëve sekondare "Nikolin Xhoja", "Principata e Arbërit" dhe "Adem Jashari", në pusetat ekzistuese të kolektorit kryesor Ø 2250 mm b/arme, i cili shkarkon në stacionin e pompave nr.9, do të përmirësojë dukshëm punën e këtyre tubacioneve si dhe do të eliminojë fenomenin e përmbutjeve.

Lidhja e këtyre tubacioneve Ø 400 mm betoni me kolektorin kryesor Ø 2250 mm b/arme, do të bëhet në pusetat ekzistuese të rrugëve sekondare “Nikolin Xhoja”, “Principata e Arbërit” dhe “Adem Jashari”, me tubacion HDPE SN8 Ø 400 mm me gjatësi L=17 m për secilën rrugë.

- Lagjja nr.14 rruga”Bajram Tusha”

Kjo zonë ndodhet në pjesën lindore të qytetit në lagjen nr.14 Shkozë, e cila konsiderohet si zonë industriale e qytetit. Në sheshrrrotullimin ku kryqëzohet rruga:”Bajram Tusha me rrugën”Martin Camaj”, kolektori kryesor i ujërave të ndotura Ø 600 mm b/arme, është i dëmtuar në segmentin me gjatësi L= 50 m, duke shkaktuar grumbullimin masiv të ujërave të bardha në sipërfaqe dhe për pasojë jo vetëm vështirësi në kalimin e mjeteve dhe këmbësorëve, por dhe dëmtime të asfaltit.

Zëvendësimi i këtij segmenti të kolektorit kryesor me tubacion HDPE SN8 Ø 500 mm do të eliminojë fenomenin e përmytjeve. Mbi këtë tubacion do të ndërtohen 4 puseta kontrolli 1x1x1.5 m, të cilat do të bëjnë të mundur pastrimin dhe mirëmbajtjen e këtij kolektori.

- Lagjja nr.13 rruga” Prokop Mjergo”, Plazh

Kjo zonë ndodhet në pjesën jug-lindore të qytetit në lagjen nr.13 Plazh, e cila konsiderohet si zonë turistike. Investimi në këtë zonë do të kryhet në rrugën”Prokop Mjergo”, pasi në këtë rrugë disa objekte nuk janë lidhur me tubacionin e shkarkimit të ujërave të ndotura sipas projektit të ri zbatuar në vitin 2017, pasi banorët e kësaj zonë si banorë të përkohshëm , duke qenë se objektet frekuentohen kryesisht në sezonin e plazhit, ose në periudha të caktuara kohe, ambjentet përreth objekteve të tyre kanë qenë të mbyllura gjatë periudhës së zbatimit të projektit, duke bërë të pamundur lidhjen e gropave septike të objekteve të tyre me tubacionin e ri të shkarkimit të ujërave të ndotura.

Ndërtimi i një linje të re kanalizimi me tubacion HDPE SN8 Ø 250 mm dhe me gjatësi L=60 m do të përmirësojë infrastrukturën nëpërmjet eliminimit të gropave septike duke siguruar shërbim në sektorin e kanalizimit dhe ambjent të pastër të zonës përreth.

Në tubacion e ri të kanalizimit parashikohet të ndërtohen 3 puseta shkarkimi 80x80 cm h=100cm, të cilat do të mundësojnë lidhjen e shkarkimit të UN të objekteve me tubacionin e ri.

II. OBJEKTIVI.

Qellimi i këtij projekti është sistemimi i ujërave të ndotura për zonat e shqyrtuara më sipër nëpërmjet ndërtimit të një linje efikase kanalizimi që ti shërbejë të sotmes dhe të ardhmes duke përmirësuar në mënyrë të dukshme infrastrukturën e zonës.

III. QËLLIMI I PROJEKTIT.

Ndërtimi i linjave të reja të kanalizimit, konsiston në eliminimin e pranisë së ujërave të ndotura dhe ujërave të bardha, duke siguruar jo vetëm mirëfunksionim të rrjetit të kanalizimit, por dhe një mjedis të pastër pa praninë e ujërave të ndotura në sipërfaqe.

Projekti përfshin:

- Ndërtim linje kanalizimi UB me tubacion HDPE SN8 Ø 600 mm.
- Zëvendësim tubacioni kryesor kanalizimi me tubacion HDPE SN8 Ø 500 mm.
- Devijim kolektori kryesor të UN me tubacion HDPE SN8 Ø 500 mm.
- Ndërtim linje kanalizimi të UB me tubacion HDPE SN8 Ø 400 mm.
- Ndërtim linje kanalizimi të UN me tubacion HDPE SN8 Ø 250 mm.
- Ndërtim pusete kontrolli 1x1x1.5 m
- Ndërtim puseta shkarkimi 80x80x1.0 m.
- Ndërtim puseta shkarkimi 80x80x1.0 m.

IV. VOLUMET E PUNIMEVE.

Ndërtimi dhe rikonstruksioni i linjave të kanalizimit të UN dhe UB, objekt i detyrës të projektimit, përfshin punime shtresa betoni dhe ndërtimin e pusetave të shkarkimit b/a 0.8x0.8x1.0m dhe 0.8x0.8x1.5 m si dhe pusetë kontrolli b/a 1.0x1.0x1.5 m

Volumet kryesore të punimeve janë:

1. Prerje asfalti	m ²	232
2. Prerje shtresa betoni	m ³	5
3. Gërmim dheu me makineri	m ³	468
4. Transport dheu me makineri	m ³	468
5. Mure betoni C 12/15	m ³	20
6. Konstrukione metalike të përbëra	ton	2
7. Shtresë rëre	m ³	154
8. Mbushje me çakëll makinerie	m ³	175
9. Nënshtrësë zhavorri	m ³	25

10. Shtresë betoni C 16/20	m ³	5
11. Shtresë çakëlli mbeturinë t=10cm	m ²	88
12. Shtresë stabilizant t=10cm	m ²	88
13. Shtresë binderi t=5cm	m ²	232
14. Shtresë asfalto/betoni t=10cm	m ²	232
15. Pusetë kontrolli 1x1x1.5 m	copë	9
16. Pusetë shkarkimi b/a 80x80cm h=100cm	copë	3
17. Pusetë shkarkimi b/a 80x80cm h=150cm	copë	2

V. KONKLUSIONE.

Në përfundim të projektit për zonën në studim me objekt “Ndërtim rrjeti kanalizimi UN lagjjet nr.7 dhe nr.10 “konkludojmë si më poshtë:

Projekti do të realizohet në një fazë.

Preventivat e zbatimit janë vlerësuar sipas VKM. Nr.629 date 15.07.2015.

Në preventiv është përfshirë Fondi rezerve 5% dhe dhe 20% T.V.SH

Analizat e çmimeve sipas normativave të tregut.

Projektues

Ing. Hidro.Gerald Dautaj
 Ing. Hidro. Lorenc Facja
 Ing. Hidro. Bledar Metalla
 Ing. Hidro. Qamile Qehajaj
 Ing. Ndertimi.Artor Koçilja

PROJEKT ZBATIMI

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION LINJA KANALIZIMI TË UN DHE UB, LAGJJA NR. 1 SHESHI “TAULANTIA”,LAGJJA NR.13 RRUGA ”P. MGJERGO” LAGJJA NR.14RRUGA”B. TUSHA” DHE LAGJJA NR.17 RRUGA“GLAUKIA”, DHE “VLLAZËRIMI”, DURRE’S”

- ☐ RELACIONI TEKNIK
- ☐ PREVENTIVI I OBJEKTIT
- ☐ ANALIZAT TEKNIKE TË ÇMIMEVE
- ☐ SPECIFIKIMET TEKNIKE
- ☐ FLETË PROJEKTI

PREVENTIV

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION LINJA KANALIZIMI TË UN DHE UB, LAGJJA NR. 1 SHESHI “TAULANTIA”,LAGJJA NR.13 RRUGA ”P. MGJERGO” LAGJJA NR.14RRUGA”B. TUSHA” DHE LAGJJA NR.17 RRUGA“GLAUKIA”, DHE “VLLAZËRIMI”, Durrës”

ANALIZA TEKNIKE

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION LINJA KANALIZIMI TË UN DHE UB, LAGJJA NR. 1 SHESHI “TAULANTIA”,LAGJJA NR.13 RRUGA ”P. MGJERGO” LAGJJA NR.14RRUGA”B. TUSHA” DHE LAGJJA NR.17 RRUGA“GLAUKIA”, DHE “VLLAZËRIMI”, DURRE’S”